

# VETËVENDOSJE!

KOPJIMI LEJOHET.  
TË LUTEM KOPJOJE!

GAZETË JAVORE | 20 shtator 2005 | nr. 6 | www.vetevendosje.org

## Letër Kai Aides



Foto: Rezaert Galica - Gji

Brezat e rinj gjejnë zgjidhje për problemet e tyre në lëvizjet kolektive. Duke zgjedhur një lëvizje, ata shpejtojnë zgjidhjen e problemit.

Albert Memmi

### Editorial

Përveçse regjim antidemokratik, UNMIK-u është edhe administratë koloniale. Historia gjashtëvjeçare e UNMIK-ut, është histori e mohimit sistematik të historisë sonë. UNMIK-u nuk ua njih të kaluarën vendasve. Administratat koloniale kur vendosen në një vend, ato mëtojnë ta zhdukun historinë. Koha zë të numërohet nga momenti i instalimit të tyre. Institucionet krijohen jashtë historisë. Mbamendja kolektive duhet të zbehet. Madje, siç shkruan Albert Memmi në librin e tij "Kolonizatori dhe i kolonizuar", vendasit duhet të përfundojnë duke e anashkaluar dhe heshtur të kaluarën e tyre. Ky libër që trajton një vend të Afrikës, edhe pas gjysëm shekulli, është shumë aktual, por kësaj rradhe për një vend në truallin e Evropës - Kosovën.

Ndërkombëtarët që njëherë hyjnë në UNMIK, nuk e lëshojnë pozitën e tyre përveç nëse nuk gjejnë ndonjë pozitë më të lartë, gjë që vështirë se mund t'iu ngjajë gjetiu përveçse sërish në Kosovë. Ata s'i japin llogari popullatës vendase, i kanë pagat e majme, shpenzimet e ulta, vendin e punës të garantuar, dhe ngjitjen në karrierë rapide. Privilegji, uzurpimi dhe jolegjitimiteti i tyre racionalizohen duke i ngritur në qiell meritat e UNMIK-ut dhe duke potencuar paaftësitë e vendasve. Më rrallë publikisht, por shumë shpesh privatisht, zyrtarët e UNMIK-ut flasin për natyrën dhe mentalitetin e vendasve. I paragjykojnë vendasit. Krijojnë një imazh për ta, i cili ua justifikon atyre privilegjet që i kanë, por edhe tezën se është në interesin e vetë vendasve që të mos vetëqeverisin, meqenëse ata janë të paafte dhe të korruptuar. Në fakt, sistemi i UNMIK-ut mbushet veçse me njerëz të korruptuar sepse vetëm ata mund ta përjetësojnë karakterin antidemokratik të sundimit. Përfundimisht, fuqia e regjimit funksionalizohet në përmbushje të këtij paragjykimi, në shndërrimin e vendasve ashtu siç i sheh regjimi.

Administratorët dhe zyrtarët e UNMIK-ut ndikojnë nëpër kryeqytetet e vendeve të fuqishme botërore që atje të merren vendime që e ruajnë UNMIK-un. Këta nëpunës, të cilët nëpër vendet e tyre do të ishin mediokër, po e bëjnë kësaj më konservative politikën e jashtme të atyre vendeve ndaj Kosovës. Të mësuar me privilegje në Kosovë, ata do të jenë të dëmshëm dhe problematik edhe për vendet e tyre atëherë kur të kthehen një ditë atje. Jo vetëm të privilegjuar, por nuk kanë pasur as meritat për ato privilegje. Privilegjet e tyre, ekonomike dhe simbolike, janë të pakontrollueshme edhe nga vetë ata. Zyrtari i UNMIK-ut hedhet në ato privilegje të cilat janë të implantuara në sistem. Në fillim ai përipiqet të shfaqësohet për situatën e tij, por më vonë përfundon duke e justifikuar tërë sistemin. Dikur, edhe për privilegje fare të vogla e mbron gjithë sistemin. Administratorët në vend se ta kuptojnë realitetin politik dhe ekonomik, i cili i kushtëzon njerëzit, ata moralizojnë ndërkohë që e mirëmbajnë sistemin i cili i shtyp njerëzit. Neve bota na sheh me sytë e UNMIK-ut. Dhe, nuk na sheh fare. E sheh vetëm UNMIK-un që na është mbivendosur. Ai që të shtyp, të izolon për të të shtypur. Madje, na shtypin dhe na quajnë të prapambetur. Na e mohojnë vullnetin dhe rrëfejnë se si jemi të pazhvilluar. Ne jemi të pazhvilluar pikërisht sepse jemi të shtypur. Dhe, ne jemi edhe të përjashtuar përveçse të shtypur. Kushtet shtypëse janë shtypja. Pamundësia objektive vjen nga përjashtimi.

Administratorët e UNMIK-ut nëpër vendet e tyre gëzojnë të drejtat që ua mohojnë vendasve në Kosovë. Lëvizja VETËVENDOSJE! e lufton UNMIK-un në emër të vlerave të OKB-së; e kundërshton administratën në emër të vlerave demokratike të vendeve prej nga vijnë administratorët. Po kështu i ka ndodhur çdo lëvizje dekolonizuese. Kolonizimi s'të bën dot shtet, s'të ofron dot mirëqenie. Dekolonizimi është parakusht për këto. UNMIK-u nuk ka interes që ta zhvillojë Kosovën, sepse ka interes që ta mbajë të sunduar atë. Nëse UNMIK-u nuk largohet, atëherë ai do të rrëzohet. Sepse po kalbet. Vetëmjaftueshmërinë e pason dekadencia. Ne s'duhet të relaksohemi edhe për një tjetër arsye: kur të rrëzohet UNMIK-u, nuk duhet të na bie në kokë.

Albin Kurti

Në Kosovë nuk po ngjan asgjë që s'ka ndodhur më parë: populli edhe sot e kësaj dite nuk mund të vendosë për fatin e vet - atij i është mohuar liria. Ju s'po bëni asgjë ndryshe nga ç'bënë të tjerët para jush, sepse fati i vendit tonë ka qenë gjithnjë çështje zyrtarësh ndërkombëtarë nga Brukseli apo Nju Jorku, por asnjëherë mundësi e popullit për t'i vetëpërcaktuar dhe ndjekur lirisht interesat e veta thelbësore kolektive.

Si nëpunës i OKB-së, ju nuk jeni kurrfarë përjashtimi. Bile, edhe po deshët të ishit i tillë, nuk mundeni. Në momentin kur vendosët ta merrni funksionin që po ushtroni, dikush tjetër ua prezantoi planin e punës që duhet ta ndiqni. Pranuat. Erdhët në një vend ku mekanizmat institucionalë të shtetit të Serbisë vetëm në luftën e fundit kanë vlarë mbi 12.000 njerëz të paarmatosur, kanë djegur dhe shkatërruar 120.000 shtëpi, kanë dëbuar rreth 1 milion njerëz, kanë dhunuar mijëra femra dhe kanë rrëmbyen mbi 3.000 persona, prej të cilëve

shumica ende të pagjetur. Dhe në vend që të shkoni në Serbi për kërkim llogaridhënieje për këto krime mizore, ju erdhët këtu si person vlerësues i nivelit të plotësisht të këtyre kriterëve të padrejta, këtyre standardeve raciste, që i janë parashtruar popullit të Kosovës. Ç'punë e pandershme!

Pse standarde raciste?, do të pyesni. Të tilla, sepse ato shërbejnë si detyra të imponuara që populli i Kosovës u dashka t'i bëjë para të tjerëve për ta dëshmuar denjësinë e tij që t'i meritojë negociatat me shtetin e Serbisë, ende pa u pasë dënuar ajo, ende pa u realizuar drejtësia elementare. Negociatat para drejtësisë, janë varrosje e kësaj të fundit.

Por, jo vetëm kaq: ju mund të mos e dini, por standardet që vlerësoni ju janë një farsë. Ato as që kanë raport shkakësor me fillimin e negociatave. Në të vërtetë, ju nuk vini në vendin tonë që të vlerësoni arritjet objektive të standardeve, por vetëm që ta vlerësoni përshtatshmërinë e klimës politike dhe

disponimin popullor për t'iu dhënë bisedimeve dritën e gjelbër.

Liderët nuk kanë qenë asnjëherë problem për ju, sfidë mbetet vetëm populli. Sa herë erdhët në Kosovë, mbledhët 4-5 liderë, biseduat me ta, u fotografuat duke buzëqeshur dhe shtrënguar dorën njëri-tjetrit, dhe këtu e reduktuat gabimisht krejt disponimin politik të 2 milion njerëzve. Jorastësisht takoheni vetëm me këta njerëz: këto gjashtë vitet e fundit UNMIK-u me përkushtimin më të madh - duke toleruar dhe lejuar korruptimin - ka investuar në shantazhimin e tyre. Dhe kështu paturpësisht manipuloni.

S'do mend - përgjatë gjithë kohës ju për asnjë moment s'mund ta fshihni komoditetin e misionit tuaj. Herave tjera keni qenë tjetërkund, kësaj rradhe qëlloni të jetë Kosova. Dhe do të ikni nga këtu me lehtësinë që erdhët. Aq ju bën: pasojat e vendimeve tuaja nuk do t'i vuani asnjëherë personalisht. As fëmijët tuaj. Por, gjithsesi, ato do t'i vuaj një popull i tërë.





# Mendimi si luks

**Gëzim Krasniqi**

Kolonializmi rëndom është shoqëruar me përjashtimin e popullatës vendase nga procesi politik. Një gjë e tillë është realizuar në forma të ndryshme; legalizimi i ndarjes së shoqërisë në klasa dhe shtresa shoqërore, është një nga mënyrat e realizimit të përjashtimit nga politika të njerëzve nën sundimin e huaj. Sipas karakteristikave të popullatës së kolonizuar, ndarja e njerëzve në klasa bëhet në bazë të ngjyrës, etnisë, religjionit, gjendjes ekonomike etj. Në çfarëdo rasti, një individ pjesëtar i administratës kolonizatore, çdoherë kishte statusin e superiorit dhe përparësisë absolute në krahasim me njerëzit e tjerë, vendasit. Këta të fundit, sadoqë mund të kenë pasë dallime të shumta ndërmjet veti, në raport me kolonizatorët ata ishin të dorës së dytë, madje të 'padenjë' për t'u krahasuar me sunduesit. Ishte pikërisht ky raport që përjashtonte vendasit nga politika.

Asgjëmangut, gjendja e rëndë socio-ekonomike dhe kushtet tmerrësisht të këqija për jetë të njerëzve të kolonizuar, bënë që përjashtimi nga procesi politik i popujve të sund-

uar të ishte i gjithpranishëm, edhe sikur një gjë e tillë të mos ishte sanksionuar dhe vendosur paraprakisht me dekrete, ligje e vendime të administratave kolonizatore. Vendimet dhe veprimet politike, ushtarake e ekonomike të shumë qeverive dhe administratave kolonizatore, për shekuj me radhë krijuan një hartë të re të botës, në një pjesë të madhe të së cilës, në vend të njerëzve dhe qytetarëve me të drejta të barabarta, kishte turma, frymë, kokë banori dhe numra. Mendimi dhe ideologjia ekskluzivisht janë të rezervuara për kolonizatorët. Të kolonizuarit detyrohen të besojnë çfarë u thuhet, nuk u lihet të mendojnë vet. Për ta mendimi është luks!

Sot, administrata ndërkombëtare e UNMIK-ut, gati me të gjitha karakteristikat, përbën sundimin neokolonialist në vendin tonë. Siç e do tradita e kolonializmit, edhe kjo administratë e vendosur në vendin tonë, është e gjithëpushtetshme. Përjashtimin e popullatës lokale nga procesi politik e ka karakteristikë gjithashtu. Veçse, sa për të krijuar iluzionin e demokracisë, njerëzve në Kosovë u është mundësuar të votojnë. Votohet pa mandatin

dhe mundësinë për të ndryshuar sistemin apo përcaktuar bazat ideologjike të tij. Me Rezolutën 1244 dhe rregulloret e ndryshme, ne jemi përcaktuar të padenjë për të qenë qytetarë dhe njerëz të orientuar ideologjikisht e politikisht. Në vend të qytetarëve të orientuar politikisht dhe ideologjikisht, sistemin politik në Kosovë e përcaktojnë dhjetëra mijëra burokratë, që në emër të ndërtimit të paqes dhe bashkëjetesës multietnike, kanë ndërtuar një administratë neokolonialiste. Gjithë ata njerëz në Kosovë që përmes formësimit politik dhe ideve të mirëfillta politike e ideologjike janë të përcaktuar për t'i shërbyer vendit të vet, për UNMIK-un janë armiq të sistemit dhe madje edhe të demokracisë. Sistemi politik në Kosovë, i vendosur dhe mbajtur nga UNMIK-u, nuk pranon mendimin, idetë dhe përcaktimet ideologjike.

Në kushtet e një inxhinieringu të vazhdueshëm shoqëror të UNMIK-ut, dhe të ballafaquar me kushtet shumë të rënda ekonomike e sociale, njerëzit në Kosovë në masë të madhe karakterizohen nga mungesa e ideve dhe mendimit politik. Inxhinieringu i UNMIK-ut është i përgjithshëm dhe përf-

shin çdo gjë. Është përpjekje që të krijohet njeriu e ri, të drejtë ideologjikisht. Njëjtë sikur të jetonim në botën orvelliane të '84, ku të jesh ideologjikisht i drejtë do të thotë të mos mendosh - të mos kesh nevojë të mendosh, të jesh i pavetëdije. Pavetëdija politike e njerëzve në Kosovë është rezultati i inxhinieringu social, dhe qëllimi i administratës neokolonialiste të UNMIK-ut. Procesi i krijimit të njeriut të ri në Kosovë, të zhveshur nga çfarëdo ideje, mendimi a ideologjie politike, zhvillohet në mënyrë konsekuente dhe ka depërtuar deri tek ndërhyrja nga UNMIK-u për të rishkruar komplet historinë e Kosovës. Duke rishkruar historinë, administrata neokolonialiste në Kosovë përpiqet të kontrollojë të kaluarën. Krejt njëjtë sikur në botën orvelliane, ku parulla e partisë thoshte: kush kontrollon të kaluarën, kontrollon të ardhmen; kush kontrollon të ardhmen kontrollon të kaluarën!

Mendimi dhe idetë politike e ideologjike sot janë më se të domosdoshme për qytetarët e Kosovës dhe plotësisht të padëshirueshme për UNMIK-un. Të domosdoshme, mu për faktin se ato japin njëfarë

shpjegimi përse gjërat janë kështu siç janë, sepse japin kritere për të dalluar të vërtetën dhe të favorshmen nga e pavërteta dhe e pafavorshme. Mbi të gjitha, ato janë të domosdoshme për të përcaktuar drejtimin e rrjedhave politike dhe shoqërore, si dhe për të dhënë një organizim për veprim. Ja pra pse mendimi nuk është luks por domosdoshmëri, nevojë permanente për të ndikuar fatin dhe të ardhmen e vetvetes. Ai është kushti i domosdoshëm për individin për të bërë hapin e madh të shndërrimit nga objekti (pjesë e turmës, frymë, kokë banori dhe numër), në subjekt (qytetar i përgjegjshëm dhe njeri me mendim e ide të qarta politike e ideologjike). Mendimi dhe idetë politike e ideologjike, me bazament në vullnetin e popullit të Kosovës për liri dhe vetëvendosje të pakusht - pashmangshmërisht të shoqëruara me aksion qytetar, janë arma më e fortë në duart e qytetarëve për çlirim nga sundimi neokolonialist në vendin tonë. E numrat? Ata mbesin për administratën neokolonialiste të UNMIK-ut; mbesin për të llogaritur ditët e largimit të saj nga Kosova...



# Nënvetëdija e pushtetit të korruptuar

E pavetëdijshmeja është e strukturuar si gjuhë  
Jacques Lacan

Glauk Konjufca

Kritika është ndër format më të mprehta të grishjes së nënvetëdijes. Kurse, reagimi ndaj kritikës rëndom është vetëzbulimi i nënvetëdijes. Dekonstruktimi i kësaj të fundit bëhet më së miri duke zbrëthyer kuptimin e reagimit ndaj kritikës.

Në një rast, kur patëm kritikuar strukturat udhëheqëse të UP-së, ato patën reaguar duke na konsideruar si 'dorë e zgjatur' e tjetërkuajt. Thjeshtë, njerëzit mendonin që studenti nuk mund të jetë ai, i cili ta ketë mendimin e tij kritik autonom ndaj padrejtësive që ndodhnin në UP. Nënvetëdija e tyre vetëshpalosej përmes mekanizmit të projekcionit. Projektimi i instrumentalizimit të kritikës sonë bëhej vetëm ngaqë ata vetë ishin instrument i dikujt tjetër (i një partie politike, p.sh.). Ata s'mund të dilnin jashtë nënvetëdijes së tyre. S'mund të gjykonin jashtë pozicionit, të cilin përfaqësonin.

Kjo është saktësisht nënvetëdija që shquan pushtetarët, të cilët, pozicionin e tyre e shohin si më të favorshmin burim keqpërdorimesh. Reagimi i tyre i zakonshëm ndaj një kritike konstruktive që pahtëson qartë korruptimin e pushtetit, merr formën e një përpjekjeje zhvleftësimi duke projektuar si qëllim të kësaj kritike marrjen e pushtetit. Prirja që këtij qëllimi të projektuar t'i atribuohet një e keqe imanente tregon konceptin e tyre për pushtetin: një instrument për pasurim personal të paligjshëm.

A s'po ndodh sot e njëjta fushatë stigmatizimi për

VETËVENDOSJE!-n? Çohen liderët e shkretë politik dhe akuzojnë: 'mos e ndiqni këtë Lëvizje, sepse ata do të bëhen parti politike!'. Çdo mendim ngërthen një presupozimin të fshehur. Në këtë rast, pjesa e fshehur e këtij mendimi thotë: 'ata do të bëhen si ne'. Pra, mos u besoni atyre, sepse njëjtë sikur ne, edhe ata kanë për synim të bëhen ca shpërdorues tenderesh dhe mashtues të popullit. Akuzat e tyre automatikisht nënkuptojnë pranimin e inkriminimit.

Në këtë pikë, s'mund të mos bëj një parabolë të largët me Dostojevskin. Tek vepra madhështore Vëllezërit Karamazovë, Grushenjkja - një femër e përdalë dhe zemërkazmë, në të cilën ishin të dashuruar marrëzisht Fjodori dhe djali i tij i madh, Dimitri, e gjen veten tek rri me vëllaun më të vogël të Karamazovëve - Aljoshën; ky i fundit një njeri skajshmërisht i moralshëm dhe i mirë deri në naivitet. Në një të tillë situatë, ndodh një gjë e çuditshme: përballë padjallëzisë së Aljoshës, Grushenjkës fillon e i bëhet vetja e padurueshme. Vetëdija për këtë diferencë thelbësore dhe cilësisht morale e bren deri në neveritje. Dhe fillon procesi i shmangies së kësaj shpërputhjeje shpirtërore cilitëse. Në pamundësi për ta duruar Objektin e shkakut të Diferencës, ajo synon suprimimin e Tij. Ideja e Dostojevskit është më se e qartë: trazimi i të keqes së vetëvetëdijshme fillon si reaktion ndaj një Rezistence kualitativisht dalluese. Shpëtimi i Grushenjkës manifestohet si përpjekje për gëlltitjen e

Objektit të Dallimit. Ajo i ulet atij në prehër sa për ta tunduar - e vetmja mënyrë që ta shkaktojë njëjtësinë absolute morale të shpirtërave, e pra, zhdukjen e çfarëdo disonance shpirtërore, hedhjen e kësaj barre të padurueshme.

Të njëjtin fenomen mund ta shquajmë edhe tek filmi i Michael Lehmann-it - 40 Days & 40 Nights. Kur Matt Sullivan-i, i lozur nga Josh Hartnett-i, vendos për agjërimin seksual dyzetditësh, në fillim shokët e tij bëjnë shaka me të, duke e parë një gjë të tillë si krejt të pamundshme. Por teksa ai po i afrohej suksesshëm këtij afati, çohen i madh e i vogël për ta penguar dhe për t'ia shkatërruar betimin. Shumë lehtë e shpjegueshme pse: përveçqë shumë shokë kishin vënë bast që një agjërim i këtij lloji s'mund të ndodhte, ata - dhe ky është thelbi i reagimit të tyre - shihnin në zotimin e Matt-it ndrydhjen e konceptit të jetës së tyre 'pashmangësisht' 'promiskuite', siç do ta quante Zhizhek-u. Lufta e tyre shpjegohet si nevojë e brendshme për 'natyralizimin' e hedonizmit të tyre të shthurur. Mostoleranca e shqetësimit themelohet mbi vetëdijen e identifikimit të Dallimit.

A s'janë akuzat e partive tona politike për VETËVENDOSJE!-n përpjekje e dështuar për suprimimin e Dallimit traumatik për to? Elitat e tyre duan ta totalizojnë çfarëdo nisme të pastër në shkryerjen e tyre korruptuese. Në mënyrë që totalizimi ta zhdukë Dallimin. Dhe klasa politike të shfaqësohet. Por, kot.



KOMENT

## Rugova, PDK-ja dhe takimi Haziri-Lonçar

Shkëlzen Gashi

1.

Pas takimeve që Kryetari i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, ka zhvilluar me shefin e zyrës amerikane në Prishtinë, Philip Goldberg, dhe shefin e administratës ndërkombëtare në Kosovë, Soren Jessen Petersen, ka thënë se me gjithë insistimin e tij për njohjen direkte të pavarësisë së Kosovës, udhëheqësit shqiptarë megjithatë duhet t'i bëjnë përgatitjet e nevojshme për bisedimet e mundshme mbi statusin përfundimtar. Përkritazi me këtë ai edhe ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës të miratojë përcaktimin e tij në emërimin e ekipit të 'unitetit'. Deri para emërimit të ekipit negociator, ai gjithëherë ka thënë se nuk do të ketë negociatë. Tash, po pranon që të ketë negociatë. Rrjedhimisht, më pas ai dhe të tjerët në ekipin negociator do ta pranojnë edhe kompromisin që do t'u ofrohet nga organizatorët e këtyre negociatave. Edhe përkundër insistimit për njohje të drejtpërdrejtë të pavarësisë. Dr. Rugova po e pranon se ka bërë koncesion, ndërsa, Kryeministri i Kosovës edhe pas emërimit të ekipit negociator po thotë se çështja e pavarësisë së Kosovës nuk do të debatohet me Beogradin, por me këtë ekip do të përcaktojmë strategjinë se si do t'i qasemi çështjes së statusit final. Çfarë demagogjie!

2.

Çdo vendim konsensual brenda spektrit politik kosovar Partia Demokratike e Kosovës (PDK) do ta respektojë dhe do të marrë përgjegjësitë që i takojnë për implementim. Kështu ka deklaruar PDK në një njoftim për media pas deklarës së Kryetarit të Kosovës, Ibrahim Rugovës, për formimin e ekipit negociator, ku si pjesë e këtij ekipi parashihet të jetë edhe lideri i PDK-

së. Edhe lideri i PDK-së, sikurse liderët e tjerë të këtij pushteti fiktiv, më herët pat thënë se nuk do të bisedohet me palën serbe për statusin final të Kosovës, ngase dihet që statusi i Kosovës duhet të jetë pavarësia, dhe për të s'kemi çfarë të bisedojmë me palën serbe. Pra, që të gjithë po bëjnë koncesione! Për hir të interesit personal! Madje-madje, opozita pas skandaleve që patën kapluar Qeverinë, pat paralajmëruar organizim protestash. Por, gjithsesi, çfarëdo përpjekje që ka për qëllim themelot rrëzuarjen e një njeriu përbrenda sitemit e jo problematizimin dhe refuzimin e vetë sistemit, është e reduktueshme në një luftë të pandershme për pushtet. Dhe asgjë më tepër.

3.

Takimi në Vjenë mes Ministrisë të Pushtetit Lokal, Lutfi Haziri, dhe homologut të tij serb, Zoran Lonçar, dëshmoi, mes tjerash, një fakt interesant, të cilin e potencoi edhe ministri serb: përfaqësuesve të Serbisë i është dhënë legjitimitet si bashkëbisedues të barabartë në të gjitha temat. Pra, pala kosovare jo vetëm që po pranon të negociohet fillimisht për decentralizimin, kthimin e të zhvendosurve..., e më pas edhe për statusin e Kosovës, por, për më keq se kaq, po pranon që bisedimet të bëhen me Qeverinë e Serbisë, e jo me Qeverinë e Unionit Serbi-Mali i Zi. Me këtë, nga pala kosovare Kosova po legjitimohet si pjesë e Serbisë. Në Rambuje, para se të fillojnë negociatat ka pasur shumë mosmarrëveshje mes palëve negociuese në lidhje me atë se kush me kë duhet negociuar?! Delegacioni i Kosovës me Delegacionin e Serbisë apo Delegacioni i Kosovës me Delegacionin e Jugosllavisë. Atëherë është arritur kompromisi që të negociojnë delegacioni kosovar me delegacionin serbo-jugosllav.



# Sistemi politik në Kosovë – Demokratik apo i tipit Kolonialist?!

Mehmet Musaj

Politikologu i njohur amerikan, David Easton, shpjegon funksionimin e sistemit politik, duke operuar me terma të tillë si: inputs, outputs, feedback etj. Për Easton-in, inputet paraqiten në formë të kërkesave dhe mbështetjes. Kërkesat zakonisht shprehin probleme, interesa dhe qëllime që janë të lidhura me shpërndarjen e vlerave. Ato, ndër tjerash, përfshijnë mbrojtjen dhe garantimin e lirive dhe të drejtave të individëve, grupeve të ndryshme, minoriteteve dhe, para së gjithash, ato janë sinjale se njerëzit ose grupet e caktuara duan veprim, aksion. Ndërsa, mbështetja shprehet në forma të ndryshme, duke filluar që nga njohja 'pasive' e legjitimitetit të qeverisë (njerëz që i besojnë asaj qorrazi), deri te ndërhyrja dhe pjesëmarrja më aktive e njerëzve në punën e saj: ata binden dhe zbatojnë ligjet, paguajnë taksat, shkojnë në votime etj. Në anën tjetër, outputet janë përgjigje të kërkesave dhe mbështetjes (inputeve). Thënë troç, ato tregojnë se çfarë bën qeveria, duke përfshirë hartimin e vendimeve, ligjeve, vendosjen e taksave etj.

I rëndësishëm është procesi i kalimit nga inputet në outpute. Ky proces bart në vete nismën, formulimin dhe zbatimin e vendimeve. Dhe sa më shumë që të ketë harmoni mes inputeve dhe outputeve, aq më demokratik cilësohet vetë sistemi. Ajo që na intereson neve, më tepër ka të bëjë me nismën. Zakonisht në sistemet politike të demokracive liberale, nisma lind mbi bazën e kërkesave dhe mbështetjes që vijnë 'nga poshtë', pra nga masat e gjëra të popullsisë, ato janë shtysë dhe valvulë



sigurie për veprimet e politikanëve. Shteg tjetër për nismën e vendimeve është ai 'nga lart'. Në kësi rastesh, nisma vjen si shprehje e interesit të 'udhëheqësit' dhe si e tillë është e ndërtuar mbi ideologjinë sunduese të cilën ai e përfaqon. Mirëpo, një shteg i tillë më shumë i konvenon regjimeve antidemokratike. Sa më shumë të merren për bazë nismat që vijnë nga poshtë, aq më demokratik është edhe sistemi.

Një tjetër element i rëndësishëm, i një sistemi politik demokratik, është edhe feedback-u. Ai ka kuptimin e përgjigjes ndaj vendimeve të marra nga ana e atyre që qeverisin. Shpeshherë, feedback-u kuptohet si një kërkesë e re ndaj vendimeve të marra. Është zëri që u bën thirrje qeverive, që të bëjnë përmirësime, modifikime, deri edhe ndryshime rrënjësore në vendimet e marra. Përndryshe, ata humbasin mbështetjen. Po qe se e kra-

hasojmë këtë sistem politik, me atë çfarë e ka instaluar UNMIK-u në Kosovë sigurisht që nuk do të gjejmë asgjë të përbashkët në mes këtyre sistemeve. Derisa në të parin, nismat që vijnë 'nga poshtë' përbëjnë fundamentin e shteteve demokratike, në sistemin politik në Kosovë, UNMIK-u dhe PSSP-ja janë GJITHÇKA. Gjithçka që vjen nga poshtë shkilet, çdo nismë që shpreh vullnetin e popullsisë në Kosovë përçmohet, pikërisht nga ata, që kush më herët e kush më vonë bartën mbi shpatulla të njëjtën padrejtësi.

Sistemi politik në Kosovë, i disenjuar nga UNMIK-u, karakterizohet me nisma që vijnë 'nga lart', e që s'janë vullneti i popullit të Kosovës, por shprehje bindjesh të katër apo pesë personave, të cilët jo vetëm që nuk janë kosovarë, por as nuk janë të familjarizuar me realitetin e Kosovës. Rezoluta 1244, Korniza Kushtetuese, Standardet për

Kosovën!... janë nisma që kanë ardhur nga lart, ngase nëpër të tilla rrugë vjen edhe pushteti i PSSP-së. Ai buron nga lart, dhe aspak nuk është

mishërim i vullnetit të qytetarëve të Kosovës. Ata që në Kosovë votuan, nuk kanë votuar për këtë pushtet, ata votuan për pseudopushtet.

Pak më parë thamë se feedback-u është një nga elementet themelore të një sistemi politik demokratik. Po kush e luan këtë rol në rastin e Kosovës? Deri para do kohësh, fatkeqësisht askush, ndërsa tani Lëvizja VETËVENDOSJE! është ajo që përmes aktiviteteve të saja vepron si kërkesë e re, kundërshtim të vendimeve që prodhon sistemi politik në Kosovë. Por, përkundër kësaj shprehje të madhe të pakënaqësisë, pushteti i vërtetë në Kosovë (UNMIK-u), nuk po rrezikohet. A mund të quhet demokratik ky sistem politik?! Assesi! Sistemi aktual politik në Kosovë ka të gjitha tiparet e një sistemi neokolonialist!



Lëvizja VETËVENDOSJE! është komunitet i njerëzve që refuzojnë të nënshtrohen. Ajo synon arritjen dhe realizimin e vetëvendosjes për popullin e Kosovës. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet edhe për ndryshime radikale shoqërore e politike që do të mundësonin respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe drejtësisë sociale për të gjithë dhe secilin në Kosovë pa kurrfarë diskriminimi.

**VETËVENDOSJE!**

**KOPJIMI LEJOHET.  
TË LUTEM KOPJOJE!**

Kroi i Bardhë, nr. 76  
Lagja Dardania  
Prishtinë, Kosovë

038 541411  
vetevendosje@hotmail.com  
vetevendosje@yahoo.com  
vetevendosje@gmail.com  
www.vetevendosje.org